

## **THIRRJE PËR APLIKIM PËR PROJEKTE SPORTIVE**

Bashkia Durrës është e angazhuar për të promovuar aktivitetet sportive dhe për të kontribuar në zhvillimin e sektorit sportiv në rajonin tonë. Me këto projekte, synojmë të krijojmë një gamë të gjerë aktivitetesh sportive që do të ndihmojnë në hapjen dhe promovimin e sportit në komunitetin tonë.

Përvoja sportive dhe natyrore e rajonit tonë ofron një bazë të shkëlqyer për zhvillimin e aktiviteteve sportive. Për këtë arsye, planifikojmë të organizohen një gamë e gjerë aktivitetesh, duke përfshirë:

- Maratona ose aktivitete të ndryshme sportive të tjera për komunitetin.

Projektet duhet të synojnë të sigurojnë një përvojë të re dhe të ndryshme, duke promovuar një mënyrë të shëndetshme dhe aktive të jetës.

### **Kriteret e Aplikimit:**

- Organizatat dhe grupet sportive të interesuara për të zhvilluar dhe implementuar aktivitete sportive.
- Aplikantët duhet të kenë një plan të detajuar për organizimin dhe menaxhimin e aktiviteteve, duke përfshirë sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit.
- Inovacioni në fushën e sportit do të vlerësohen së pari.

### **Lista e Dokumenteve:**

#### **A. Dokumentet e Kërkuara për OJF-të dhe organizatat**

1. Kopje e Statutit/Vendimit të Gjykatës të organizatës (varianti më i fundit)
2. Dokumenti i regjistrimit në organin tatimor (NIPT)
3. CV-të e anëtarëve të grupit të punës, përgjegjës për zbatimin e projektit
4. Konfirmim për bashkëfinancimin e projektit të propozuar (në se ka)
5. Vërtetim nga Drejtoria e Tatim Taksave që organizata nuk ka detyrime të pashlyera për sa i përket kontributeve për sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe tatim-taksat
6. Vërtetim i llogarisë bankare të aplikantit

## **B. Dokumentet e kërkuara për Individët**

1. CV-të e Individit apo Grupit të Punës që do të angazhohet në projekt (nëse bëhet fjalë për më shumë se një individ);
2. Vërtetim i llogarisë bankare të aplikantit në ALL (lekë);
3. Konfirmim për bashkëfinancimin e projektit të propozuar (nëse ka);
4. Deklaratë e Individit që nuk është subjekt i tatueshëm;
5. Fotokopje e Kartës së Identitetit të individit, apo të Grupit të Punës që do të angazhohen në projekt (nëse bëhet fjalë për më shumë se një individ).

### **Fondi dhe Kushtet e Financimit:**

Ne ofrojmë një fond të dedikuar për të mbështetur projekte të cilat përputhen me qëllimet dhe objektivat e projektit të kërkuar. Financimi do të shqyrtohet në bazë të kualitetit dhe qartësisë së aplikimeve të pranuar.

### **Si të Aplikoni:**

Organizatave dhe grupet sportive që janë të interesuara për të aplikuar për këtë projekt mund të dërgojnë një aplikim formal duke përfshirë një përshkrim të detajuar të planit të tyre të aktiviteteve, një buxhet të qartë dhe detaje të kontaktit.

Aplikimet duhet të dërgohen paraprakisht në adresën tonë të emailit në [info@durres.gov.al](mailto:info@durres.gov.al) si dhe rrugës postare në zyrën e marrëdhënieve me publikun në Bashkinë Durrës deri më 10.05.2024

Për informacion shtesë ose pyetje, ju lutemi kontaktoni në numrin e telefonit 052 222 310 ose në adresën tonë të emailit: [info@durres.gov.al](mailto:info@durres.gov.al)